



---

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 60**

Datë: 14. 09. 2021. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvij, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.
  - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 58/2021.
2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së;
3. Aktivitetet e ZRPPC-së:
  - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.
4. Raport i Këshillave të KQZ-së:
  - Këshilli për Operacione Zgjedhore;
  - Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për zgjedhjet për Kryetar Komune dhe Kuvendin Komunal,

- Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të VPNRV,
  - Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të pranimit dorëzimit të materialet zgjedhore nga KVV-KKZ,
  - Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së kryesuesve në vendvotim për zgjedhjet lokale 2021.
  - Shqyrtimi dhe plotësim-ndryshimi i përbërjes së KVV-ve sipas komunave përkatëse.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
  6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik.
  7. Shqyrtimi dhe miratimi i vlerësimit vjetor të punës së Kryeshefit Ekzekutiv në SKQZ-së.
  8. Të ndryshme.

---

**9. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.**

**Kreshnik Radoniqi:** E hapim mbledhjen e 61-të, a ka dikush diçka më rendin lidhur me rendin e ditës?

**Sami Kurteshi:** Faleminderit z. kryesues, unë kisha propozuar në të ndryshme me u fut një pikë e rendit të ditës si pikë e rregullt dhe, ajo është: hetimet e prokurorisë në lidhje me KQZ-në në dy vitet e fundit se janë disa hetime...

**Kreshnik Radoniqi:** Në rregull, se nuk munda me të kuptuar, e çka me diskutuar në për hetimet e prokurorisë...?

**Sami Kurteshi:** Faleminderit, po para një dy vite janë pas helmuar një dy mijë apo pesë, gjashtë mijë vota e u pat bo nami në Kosovë, e i publikun krejt mediat e u çmenden njerëzit që dy vite nuk dëgjohet më asgjë sikur mos më pas ngjare asgjë.

**Kreshnik Radoniqi:** Në rregull e kuptova, atëherë nëse nuk ka dikush diçka tjetër e hedhim në votim rendin e ditës, kush është për këtë rend të ditës më piken që e propozoj z. Kurteshi.

Më 9 vota për, më 1 abstenim miratohet rendi i ditës.

## **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit.**

E keni pranuar procesverbalin nr. 58-të, a ka dikush diçka lidhur më këtë procesverbal më shtuar, jo atëherë e hedh në votim. Kush është për miratimin e procesverbalit 58-të ?

Më 10 vota për miratohet procesverbali 58-të i mbledhjes së KQZ-së.

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit**

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit Kryetar, të nderuar anëtare të KQZ-vë, sekretariat i komisionit qendror të zgjedhjeve në kuadër të përgatitjeve është duke punuar në shumë aktivitete një nder to është edhe përudha e votimit përmes postes për votuesit jashtë vendit përudhë e cila ka filluar më 15 shtator dhe do të përfundoj më 15 tetot të vitit 2021. Pra, para se të filloj kjo përudhë ashtu siç është përcaktuar edhe më planin operacional të zgjedhjeve lokale sekretariat ka dërguar pakot e fletëvotimeve për aplikuesit e regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës të cilët, kanë aplikuar në përudhen nga data 10 korrik deri më 18 gusht, pra pakot më fletëvotime janë dërguar për rreth 15,500 aplikues përmes emalit që kanë përmbajtur informata lidhur më linkun e fletëvotimeve për kryetare të komunave të cilën mund të shkarkojnë përmes internetit.

Linkun për fletëvotime për kuvend komunal, e po ashtu edhe këtë fletëvotim, mund të shkarkojnë përmes internetit, linkun me broshura të kandidatëve për asamble komunale, postierët e votimit përmes postes si dhe linkun për video spote për mënyrën se si të plotësohet fletëvotimi. Pra, këto janë informatat të cilat janë dërguar rreth 15.500 aplikuesve të cilët mund të votojnë përmes postes.

Sekretariat po ashtu në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet lokale ka dizajnuar formular të rezultateve FPR për kryetare komune dhe FPR për kuvendin komunal dhe formular të rezultateve të kandidatëve dhe formave tjera që ndërlidhen më subjektet politike dhe kandidatet sipas renditjes në fletëvotim dhe broshura më lejoni të ju njoftoj së ka filluar procesi i printimit të fletëvotimeve për kryetare të komunave dhe kuvendin komunal nder aktivitetet tjera janë pra edhe njoftimet e KKZ-ve për numrin e vendvotimeve ne baze të kësaj janë edhe duke u përcaktuar propozimet e këshillave të fletëvotimeve sipas listave të pranuar nga subjektet politike pra gjithmonë më afatin ligjore neper vendvotime dhe në qendrat pra lidhur më këtë KQZ-ë ka votuar edhe formulën e përbërjen këshillave të vendvotimeve në zgjedhjet e fundit krahas kësaj sekretariat përmes zyrave të kryetareve të lart komunal të zgjedhjeve neper

secilën komune ka dërguar edhe ftese subjekteve politike për nominimet e këshillave të vendvotimeve, më lejoni të ju njoftojmë së më datën 16 shtator KQZ-vë ka zhvilluar vizita në dy rajone, vizita neper zyre komunale të zgjedhjeve të ndare në dy ekipe, vizitat kane qene në komunat Malisheve, Rahovec, Mamushë, Suhareke, Prizren dhe Dragash ku KQZ-ë është njoftuar për se afërmi për kushtet e punës dhe përkrahjen të cilën i nevojitet të i ofroj KQZ-ë për secilën zyre komunale si dhe përkrahjen që i nevojitet të i ofrohet zyrtareve komunal dhe KKZ-së nga niveli komunal.

Në të njëjtën kohë, tha z. Ahmetaj, janë njoftuar edhe ndryshimet procedurale të cilat KQZ-ve i ka miratuar që kanë të bëjnë më procesin e votimit pra është fjala për kabinat të cilat do të vendosen për personat më nevoja të veçanta në secilin vendvotim pra për personat më nevojë është fjala dhe plotësimi i arsyes në librin e votimit për votuesit që votojnë më asistence pra kjo është në aspektin e votimit, ndërsa në aspektin procedural ka të beje me mbushjen dhe plotësimin e fletave llogaritëse të kandidateve dhe mënyrën e procedimit dhe ajo çka është më rendësi është edhe përmbajta e kutive të votimit që nuk do të jene më në kutin e votimit vula sprej, ultraviolet uv - llamba dhe gjitha materialet administrative. Mirëpo, krejt çka mbete në kuti të votimit janë fletëvotimet e përdorua dhe të pa përdorte pra këto janë dy ndryshimet procedurale të cilat KQZ-ë i ka miratuar dhe i kemi prezantuar tek këshillat komunale të zgjedhjeve, rendësi e veçante i është shtuar edhe procesit të vaksinimit të trupave zgjedhore pra ka pasur diskutime lidhur më këtë aspekt pra për të gjithë trupat zgjedhore që do të angazhohen për të punuar në ditën e zgjedhjeve përfshire edhe vëzhguesit pra janë sipas vendimit të qeveris së republikës së Kosovës janë katër kërkesat të cilat duhet të i plotësojnë një nder to është edhe dëshmia për vaksinonim.

Më lejoni të ju njoftoj së trajnimi i trajnerëve në sekretariat do të filloj nga data 24 deri më 26 shtator pra është fjala për trajnimin e trajnerëve neper komuna dhe lokacioni ku planifikohet të zhvillohet trajnimi është lokacioni në akademinë policore të Kosovës në Vushtrri dhe trajnimi do të zgjatë 3 dite, dhe trajnimi do të zhvillohet mbi procedurat e votimit, procedurat e paketimit dhe procedurat e votimit të personave më nevoja veçanta, pra këto janë temat e trajnimit në baze të cilave rreth 260 trajner në ter territorin e republikës së Kosovës, dhe trajnimi do të lehtësohet pra divizioni i trajnimit dhe sigurisht ne fund të këtij procesi duhet të i nënshtrohen përmes procesit të monitorimit pra duhet të i nënshtrohen edhe procesit të testimit të trajnerëve lidhur më dhënë gjatë procesit të trajnimit. Pra në pika të shkurta këto janë disa prej aktiviteteve të sekretariatit dhe nëse keni pyetje mund te ju përgjigjem, faleminderit.

**Kreshnik Radoniqi** : Faleminderit z. Ahmetaj, a ka dikush diçka lidhur më këtë?

**Alim Rama** : Faleminderit, vetëm së kam një pyetje lidhur më kutit... ( nuk dëgjohe mirë)

**Sami Kurteshi**: Unë, kam një çështje që nuk lidhet ndoshta drejtpërdrejt më këtë po me komunitat, një çështje që kanë ngrit në Han Elezit dhe Kaçanik gjate vizitave që kanë kaluar edhe më gjase nuk i kemi përmend dhe nuk i kemi shqyrtuar, faj është edhe i joni që kemi harruar faj është edhe atyre që sekretariati që ka mbajt do shënime, më 17 tetor mbahen zgjedhjet në Maqedoni, sikur në Kosovë janë një pjese e qytetareve që votojnë në të dy vendet sidomos të komunës së Kaçanikut dhe Hanit të Elezit edhe ato fshatra për rreth dhe ata e kanë ngrit çështjen se si do të behet për shkak se, nëse votojnë në njërin vend mund të i kenë ato shenjat të gishtave.

Nuk e di edhe si e ka Maqedonia edhe a ja vlen me e diskutuar këtë çështje, a ja vlen me diskutuar këtë çështje me KQZ-në e Maqedonisë, a mundemi më bërë diçka se në të vërtetë, ka me ardhur një moment kur shumë qytetarë kanë me u detyruar mos më zgjedh fare, hiq mos më dal në votim, më zgjedh se ku po donë me votuar: në Kosovë apo Maqedoni apo edhe më zgjedhë edhe mundësinë me i provuar të dyja. Kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me KQZ-në, ka të bëjë drejtpërdrejt më votën dhe unë mendoj se ne si KQZ, duhet me e shtruar këtë çështje dhe më diskutuar sepse, nuk po them është numër jashtëzakonisht madh se nuk e di sa është por, se ka një numër të njerëzve që kanë të drejtën e votës në Maqedoni dhe në njëjtën ditë edhe në Kosovë, kjo është fakt...

**Čemailj Kurtiši**: Ju faleminderit, e kisha lutur krye shefin që për personat e hendikepuar të kontaktoj me organizatat që merren me këta persona që ata të kontaktojnë dhe, të bëjnë thirrje që të dalin sa më shumë që të jetë e mundur në zgjedhje. Unë ju kisha lutur që, së paku me ata që kontaktoni, t'ua përcillni materialin sepse të hendikepuarit komunikojnë me ato organizata, shkojnë në organizata dhe se ata më së miri din t'i informojnë...

Edhe një gjë: një pjesë të materialit nuk e pranojmë me kohë, dhe nuk ka mundësi që të njëjtin ta njoh dhe të informohemi, dhe kështu kjo është pengesë për votim sepse, nuk arrijë që të kem qasje...

**Fazli Stollaj**: Faleminderit, më 25 qershor KQZ e ka miratuar një dokument që i përbënë specifikat e kushteve që ditën e votimit të votojnë edhe të verbrit. Ai dokument, ka qene shumë i specifikuar dhe objektivat kanë qenë që të implementohet në ditën e zgjedhjeve, dhe pata një pyetje: A kemi në plan që ta implementojmë këtë...?

**Arianit Elshani**: Faleminderit, po i shoh dy pika të cilat, do të dëshiroja një sqarim nga sekretariati dhe për një tjetër thirrje për shoqërinë civile dhe qytetarët...E para, është e lidhur më Sallën e Sporteve “1Tetori” dhe zhvendosjen e kësaj qendre të votimit në Fakultetin e Edukimit që pastaj, të përdoret edhe salla e sportit të fakultetit të edukimit për depot e KKZ-së deri ku kemi arritur këtu a kemi marr ndonjë përgjigje nga rektorati më qene se raporti po besoj është ber dite më pare të premten ose dje; A keni marrë ndonjë përgjigje dhe mendoj se duhet të intensifikojmë komunikimin në raport me ta që të kemi një përgjigje dhe një konfirmim në raport me zhvendosjen e kësaj qendre sepse, është e rëndësishme se si KQZ-ë t’i i njoftojmë të gjithë ata votues që nuk janë pak të komunës së Prishtinës të cilët kane votuar deri më tani në sallën 1 tetori....

Po ashtu, mendoj se duhet të kemi një përgjigje sa ma shpejt dhe sa i përket fushatës së zgjedhjeve! Po shoh në raport se nga data 16-të shtator deri me datën 18 shtator sipas raportit, janë mbajtur 51 tubime politike duke e respektuar rregullat zgjedhore.

Unë së pari, tha z. Elshani, dyshoj në këtë numër kaq të vogël të subjekteve politike të cilët kanë mbajtur tubime politikë që e kanë njoftuar KKZ-në, andaj ftoj edhe qytetaret edhe shoqërinë civile që t’i identifikoj dhe të njoftohet lidhur me secilin tubim dhe të njëjtin, ta lajmëroj edhe në KQZ-ë apo edhe në PZAP.

E para, ne e dimë se në këto tubime politike nëse nuk respektohen masat e covidit e rrezikojnë shëndetin e qytetareve dhe e dyta, duhet të njoftohet edhe policia për këto tubime politike që mbahen dhe që mos të kemi ndonjë incident në komunat përkatëse ku zhvillohen ato tubime politike. Prandaj, mendoj se këtu duhet thirrje edhe për neve që ta njoftojmë edhe KKZ-ë dhe që të kërkojmë nga ta dhe nga gjithë përfaqësuesit e subjekteve politikë që ta lajmërojnë secilin tubim politik që e mbajnë në komunat e tyre...

**Burim Ahmetaj** : Faleminderit kryetare, lidhur më kutit e votimit të cilët duhet të asgjësohen i kemi dërguar shkresë në emër të kryetarit në këshillin gjyqësor mirëpo akoma nuk kemi ndonjë përgjigje lidhur më ato kuti dhe si do të ja bëjmë edhe pse kemi hy po thuaj se në një fazë që jemi shumë afër më pak se 30 dite larg ditës së zgjedhjeve ku objektin na duhet patjetër më e liruar në mënyre që të zhvillohet aktiviteti i furnizimit më kuti të votimit edhe pse në numër i kemi të kufizuar këto materiale të cilat duhet të asgjësohen, ndërsa sa i përket kategorive më nevoja të veçanta që përfshin edhe kategorinë e të verbërve e kemi projektin i cili është finalizuar tash dhe është zhvilluar tenderi dhe është në proces e sipër në realizimin e këtij projekti për të verbëritë po ashtu njëjste do të veprojmë edhe komunikimin më kategoritë

tjera më persona më nevoja të veçanta në mënyre që të i lehtësohet sa ma shumë dhe të ketë pjesëmarrje sa më të madhe në procesin zgjedhore.

Në lidhje më sallën 1 tetori kemi bere shkrese zyrtare UP-së dhe nuk kemi ndonjë, faktikisht salla 1 tetori ka qene qendër e cila shfrytëzohej nga KQZ-vë qendër e votimit mirëpo kemi identifikuar sallën apo lokacionin më te afërm dhe ai lokacion është fakulteti i edukimit ku jemi drejtuar më shkrese zyrtare rektoratit mirëpo akoma nuk kemi ndonjë përgjigje në këtë aspakët edhe pse kemi tentuar edhe përmes telefonit mirëpo sot do të bëjmë tentime prape në mënyre që te kemi përgjigje të sakte dhe të i informojmë votuesit më kohe se ku do të jete lokacioni i zhvendosur pasi salla 1 tetori shfrytëzohet si qendër e vaksinimit dhe imunizimit të popullatës.

Ndërsa, sa i përket fushatës zgjedhore lidhur më tubimet elektorale pra nga data 16 deri me 18 kemi pasur 51 tubime elektorale ku sipas raporteve nga zyrtaret komunal që të njëjtit të gjitha subjektet politike obligohen të njoftojnë KKZ-në dhe të marrin leje po ashtu nga policia e Kosovës raportohet se vetëm një tubim elektorale është mbajtur pa i përfillur rregullat zgjedhore kurse prej tyre 5 tubime nuk janë mbajtur këto janë raportimet e para nga tereni në mbledhjet e radhës ose nëse nevojitet edhe përmes emalit do të ju njoftojmë periodikisht në baza javore lidhur më pjesën e fushatës zgjedhore në mënyre që te jeni të njoftuar nga afër më procesin e fushatës zgjedhore përndryshe sipas raportimet nga komunat dhe KKZ-të fushata deri më tani konsiderohet e mirë mirëpo që të gjitha subjektet politike obligohen që të marrin leje nga policia e Kosovës dhe që të plotësojnë formularin në KKZ-ë sa i përket fushatës.

**Kreshnik Radoniqi:** Z. Dushi...?

**Florian Dushi:** Faleminderit kryesues, ndoshta për hire të qartësisht, sepse pyetja qysh e ngriti kolegu Fazliu dhe përgjigja se si e dhatë, del se ne për herë të parë po fillojmë ta implementojmë Alfabetin e Brajlit! Por, duhet shpjeguar për opinion se ka me dhjetëra pale zgjedhje që ne e implementojme këtë projekt dhe madje, e implementojmë suksesshëm...

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit që e korrigjuat këtë pjesë z. Dushi sepse, është e vërtetë se ne në secilin proces zgjedhore për kategorinë e të verbërve implementohet projekti i të verbërve përmes formularëve më alfabetit të Brajlit dhe, çështjet procedurale e prokurimit ka qenë deri sa është zgjedhur fituesi dhe operatori ekonomik për printimin e të gjitha këtyre dokumenteve pra d.m.th tani më e kemi operatorin ekonomik i cili do të bëjë printimin e këtyre formularëve dhe të gjitha dokumenteve që shërbejnë për dukurin e votuesve të verbër...

**Alim Rama:** Në lidhje me këtë me duk se afati ka qene në gusht, e ne tani jemi në shtator. Unë mënoj se KQZ-ë duhet me marr një vendim...

**Kreshnik Radoniqi:** Pa e marr konfirmimin nga Këshilli Gjyqësor për parashkrimin e atyre lëndëve nuk mundemi me i prekë kutit e votimit por në ditët në vijim, unë shumë shpresoj që këshilli gjyqësor do të jep këtë konfirmime dhe do të lirohen ato përveç atyre, do të lirohet edhe një pjese tjetër e zgjedhjeve të mëvonshme që jemi marr vesh edhe më prokorporinë dhe këshillin gjyqësor...

**Burim Ahmetaj:** Më lejoni të ju informoj se prokuria e shtetit e ka sjellë listën e vendvotimeve të cilat duhet të ruhen për zgjedhjet e 14 shkurtit. Bëhet fjale për një numër të komunave të cilat nuk janë të mëdha dhe rrjedhimisht, nuk është numri i kutive shumë i madh që duhet të ruhet për vendvotimet e rregullta, ndërsa ajo se çfarë ka kërkuar është që të ruhen kutitë e votimeve të votave më kusht dhe të votave më postë të zgjedhjeve të 14 shkurtit.

**Sami Kurteshi:** Përafërsisht, sa bëjnë këto kuti?

**Burim Ahmetaj:** Po, janë 300-350 të vendvotimeve të rregullta në total që duhet të ruhen për procesin 14 shkurtit, ndërsa vota më kusht dhe me vota janë rreth 150 kuti mesatarisht. Ndërsa ato të cilat kryetari i ceki të vitit 2010 dhe 2011, jemi në pritje nga këshilli gjyqësor...

## **10. Aktivitetet e ZRPPC-së**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve:

**Yll Buleshkaj:** Faleminderit shumë kryetare, të nderuar anëtar pra sa të fillojmë më rekomandimin të i jap vetëm dy apo tre informata të shkurta të jepi, për informatën tuaj shkresa e kryetarit lidhur më masat anti covid kemi dërguar të gjitha subjekteve politike të cilat janë certifikuar të gjitha entiteteve të cilat aplikojnë për akreditim të vëzhguesve po ashtu po njoftohen më këto kushte të reja të cilat janë kushte të vjetra në të vërtet për të gjithë qytetaret e vendit një informate tjetër është që auditimi i partive politike është në përfundim.

Ne si zyre, kemi pranuar një numër të raporteve financiarë të ndryshuara si rezultat i auditimit dhe të njëjtat i kemi proceduar po sa të na vine raportet përfundimtare ju do të njoftoheni ato do të publikohen dhe zyra do të përgatitë rekomandimin ne baze të te gjeturave të auditorëve të jashtëm. Një informate e tretë të cilën dëshiroj të e ndaj më ju ne kemi kërkuar nga ministria përgjegjëse për administrate publike që të na interpretoj çështjen e zyrtareve të cilët janë pjese



zyrtar publik se a ka nevojë që të bëjë pezullimin e detyrës së tyre në kuadër të ligjit për zyrtarë publikë edhe pse ligji ka qenë mjaft i qartë me këtë hapësirë besoj kemi marrë vetëm një konfirmim se po të gjithë zyrtarët publikë duhet të pezullojnë detyrën e tyre 7 ditë para fushatës dhe 5 ditë pas fushatës ashtu siç e sheh ligji. Tani të kthehemi rekomandimeve, para jush e kemi marrë një rekomandim i cili i përmban 24 nënrekomandime.

**Arianit Elshani:** Iniciativën e juve që të merreni informata nga ministria e administratës publike lidhur me kërkesën e subjekteve, pra të kandidatëve për interpretimin e ligjit lidhur me pezullimin e vendit të tyre të punës... po ata punojnë, po nëse janë në garë për asamble apo për kryetare, pra a kanë nevojë, mirëpo këtë çështje ne e dimë që e kemi diskutuar brenda KQZ-së që, ne jemi merr vesh që nuk jemi paterice e asnjë institucionit tjetër...; Kjo është çështje që është dashur të interpretohet nga institucionet tjera dhe të ju japin përgjigje të gjithë atyre që janë të interesuar me këtë temë...

Unë, e kuptoj iniciativën tuaj, mirëpo unë i kam trajtuar të gjitha tek institucionet përkatëse pra, ku ata punojnë dhe këtu ne vërtet nuk duhet të gradojmë si institucion dhe ta tejkalojmë rolin që e kemi dhe kompetencat dhe përgjegjësitë që i kemi...Pra, është çështje që ju takon atyre institucioneve...

**Florian Dushi:** Faleminderit kryesues, për me tepër unë konsideroj që kjo nuk është çështje e KQZ-së dhe as e zyrës dhe duhet të kemi parasysh një fakt edhe tejkalimi i autorizimeve është keqpërdorim pra nuk është çështje e jona nëse ata duhet të marrin pushim është çështje e institucioneve në të cilat ata janë të angazhuar. Krejt çka ndërlidhet me neve rreth këtyre kandidatëve, është nëse të njëjtit kanë plotësuar kriteret për certifikim dhe ne i kemi certifikuar, tutje janë çështje të institucioneve të ndryshme që i rregullojnë administratën publike për zyrtarë shërbyes civilë dhe zyrtarë tjerë të lart drejtues tek ministria e shëndetësisë kam dëgjuar që e kanë rregulluar ndryshe ministria e arsimit për punonjësit arsimorë ndryshe prandaj, unë konsideroj se nuk është çështje e jona dhe ne, duhet këtyre çështjeve që t'u qasemi me kujdes të veçantë dhe jo jashtë autorizimeve tona ligjore dhe autorizimeve që i kemi krijuar përmes rregullave tona zgjedhore sepse, nuk është çështje e jona...

**Alim Rama:** Kjo, ka qenë kërkesa ime ku të gjithë e kemi diskutuar, dhe unë sa e pash aty ka qenë vetëm njoftim, nuk paska qenë asgjë obligative por informativë të gjithë ne e kemi pranuar prej zyrës, sa i përket kësaj unë mendoj se ndoshta është në mangësi edhe në rregullat tona që ne nuk i informojmë të gjitha institucionet se, kush janë kandidatet...Për me qenë gara e drejtë, ish dashtë më qenë informatë publike të gjithë atyre institucioneve ose institucione qendror të

cilat njoftohen për emrat e kandidateve që mundet dikush mos me e njoftuar dhe përsëri, krijojmë një pa qartësi por mendoj që kjo duhet të zgjidhet më një rregull të caktuar sepse një fare mënyre ne jemi të vetmit që kemi listën e plote të kandidateve ne i kemi certifikuar sikur se e kontaktojmë këshillin gjyqësor të Kosovës, ministrin e punëve të jashtme, AKI-në për shkelje për certifikim, ne moment që certifikohen është dashtë të informohen institucionet tjera lidhur më ligjet në fuqi...

**Arianit Elshani:** Pra, kështu unë pajtohem se kjo çështje nuk është e rregulluar siç, duhet sepse vërtet listën e kandidateve e kemi ne dhe tash me është publike edhe në broshurë dhe ne përgjegjësitë tona i kemi krye në raport më institucionet dhe, ato çka na obligon ligji që t'i verifikojmë në qoftë se ata punojnë nëpër institucione të cilat, e ndalojnë pra certifikimin si kandidatë. këtë procese ne i kemi përfunduar, procesi tjetër është obligime i punonjësve i zyrtareve të cilët kanë në raport me ligjin sepse ligji e rregullon për ta mardheninjen e punës që ti duhesh me e pezullua vendin e punës në qofte se garon atëherë unë mendoj që kjo është në mes dy palëve është ne mes institucioni përkatës ku ai është i angazhuar dhe është mes palës pra kandidatit.

Ne, çka mendoj që është dashur të bëjmë, është që ti udhëzojmë ata pra ku cilat janë adresat pra cilat janë adresat e komunikimit të tyre pse në të vërtet ndoshta njerëzit nuk kane njohuri edhe në raport më ligjin për shërbyesit civil edhe me zyrtar publik edhe më rregullat e tyre të brendshme që i kane mund vonojnë edhe mund të mos i dijen këto procedura unë prape e vlerësoj ngadalshmërinë tone mirëpo keni parasysht që në anën tjetër po marrim edhe barrën edhe përgjegjësin për gjithë ata zyrtar që nesër në qofte se nuk e deklarojnë kandidatin e tyre në institucione ku janë të angazhuar pastaj përgjegjësia dhe barra bijën edhe të ne si KQZ-ë ku po bëhemi pale ku për këtë nuk mendoj që duhet të bëhemi pale në këtë situatë, prape thash e vlerësoj gatishmërinë dhe iniciativën por nuk na takon neve si KQZ-ë te merremi më këtë, faleminderit.

**Kreshnik Radoniqi:** A mundem unë vetëm dy fjalë më këtë çështje, qysh po e shohë unë këtë çështje, kjo nuk është punë e KQZ-së hiç. KQZ-ja nuk e ka asnjë obligime ndaj asnjë kandidati për me i treguar a duhet më ju pezulluar detyra apo jo, secili institucione për nga vine ata kandidate janë të obliguar më e respektuar ligjin. Në anën tjetër, mos harroni se ekziston atje në kodin penal një vepër penale, konflikti i interesi e nëse secili prej tyre e ndërmer ketë veprim dhe nuk heqë dorë dhe nuk e njofton institucionin e vetë e, kryen veprën penale të konfliktit të

interesit. KQZ-ja, nuk e ka për obligime më i thane kandidatit ose me i jep përgjigje ose këtë rast z. Buleshkaj ministria e administratës publike nuk na interpreton neve ligjin, ligjin e interpreton gjykata.

Ne, tha z. Radoniqi, jemi zbatues të ligjit edhe unë nuk e shoh të arsyeshme kërkesën e zyrës. E kemi diskutuar këtë poshtë, në zyre tek unë por me gjithë atë, e ke dërguar atë shkresë por, unë nuk e shohë të arsyeshme me ju drejtuar ministrisë me ma interpretuar m'u ligjin sepse, ministria nuk na interpreton ligjin. I vetmi agjencion që është i thirrur me interpretuar ligjin, është agjencia kundër antikorrupsion, diçka tjetër nuk ka përveç gjykatës që interpreton ligjin...

Në këtë pikë, diskutuan dhe ridiskutuan: Florian Dushi, Sami Kurteshi, drejtori i zyrës Yll Buleshkaj, Ibrahim Selmanaj, Alim Rama dhe Arianit Elshani.

### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve:**

Yll Buleshkaj: E keni rekomandimin para jush me 24 entitete për akreditimin të vëzhguesve për këto zgjedhje. Deri më tani, i kemi akredituar 106 vëzhgues ndërsa sot, para jush e keni rekomandimet për 6663 vëzhgues. Në total, deri më tash behën: 6769 vëzhgues në qofte se votohen. Rekomandimi i parë, është për akreditimin e vëzhguesve të partisë politike të certifikuar PDK, me 5145 vëzhgues. Ne si zyre, rekomandojmë që këta të akreditohen.

**Kreshnik Radoniqi:** Në rregull, nuk janë tani të pranishëm Sami Kurteshi dhe Rifat Krasniqi por, jemi 9 anëtarë në sallë. Kush është për këtë rekomandim...?

Më 9 vota për, akreditohen 5145 vëzhgues afate gjatë të PDK-ës. Vazhdojmë z. Buleshkaj?

**Yll Buleshkaj:** Rekomandimi i dytë, është për OJQ-në vendore "GERMIN" të cilët aplikojnë për akreditim të 7 vëzhguesve, si dhe procedurat i kanë përmbushur.

**Kreshnik Radoniqi :** Atëherë kush është për akreditimin e 7 vëzhguesve të OJQ-ës vendore GEMIN ?.

Me 9 vota për, aprovohet rekomandimi për OJQ-në vendore GERMIN-ë më 7 vëzhgues.

**Yll Buleshkaj:** OJQ-ë tjetër "Interneës Kosova" ka aplikuar për akreditimin e 18 vëzhguesve të cilët, rekomandojmë për aprovim nga ju.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Me 9 vota për, akreditohen 18 vëzhguesit e OJQ-së vendore internues Kosova.

**Yll Buleshkaj:** OJQ-ë tjetër vendore është “Rrjeti ballkanik i gazetarëve hulumtues BIRN-që ka aplikuar për akreditim me 50 vëzhguesve dhe, ju rekomandojmë juve që të aprovohen.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Atëherë, akreditohen 50 vëzhguesit e OJQ-së vendore BIRN-ë. Vazhdojmë...

**Yll Buleshkaj:** Rekomandimi i pestë, është për OJQ-në tjetër të cilët, kanë aplikuar për akreditimin e 3 vëzhguesve afate gjatë të cilët rekomandojmë për aprovime nga ju.

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë kush është për ? Akreditohen 3 vëzhguesit afatgjate të OJQ-s vendore..

**Yll Buleshkaj:** Rekomandimi tjetër është media vendore “Arbëresh. Info” të cilët kanë aplikuar për akreditim për 7 vëzhgues.

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë kush është për? Me 9 vota për, akreditohen 7 vëzhguesit afatgjate medias vendore. .

**Yll Buleshkaj:** Rekomandimi i 7-të është OJQ-ja vendore “Kosova Demokratik Institut” të cilët, kanë aplikuar për akreditimin e 9 vëzhguesve afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Me 9 vota për, akreditohen 9 vëzhguesit afatgjatë të OJQ-së vendore KDI.

**Yll Buleshkaj:** OJQ-ë tjetër është RVK –së ka aplikuar ka pa plotësuar të gjitha konditat për ti akredituar 15 vëzhgues afatgjate.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për, më 9 vota për akreditohen 15 vëzhguesit e OJQ-së vendore RVK-ë.

**Yll Buleshkaj:** Subjekti politike “Iniciativa qytetare për reformimin demokratik për Ferizajn” ka aplikuar për akreditimin e 9 vëzhguesve të cilët i kane plotësuar të gjitha kushtet për tu akredituar...

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Me 9 vota për, akreditohen 9 vëzhguesit e iniciativa qytetare reformimi demokratik për Ferizajn.

**Yll Buleshkaj**: Iniciativa qytetare “Progresi për Skenderaj” ka aplikuar për akreditimin e 13 vëzhguesve afatgjate dhe të cilët të cilët kane plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe rekomandojmë për tu akredituar.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për? Me 9 vota për, akreditohen 13 vëzhguesit afatgjate e iniciativa qytetare progresi për Skenderaj.

**Yll Buleshkaj**: Partia politike “Serbska lista” ka aplikuar për akreditimin e 210 vëzhguesve të parë afatgjatë...

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 9 vota për, akreditohet 210 vëzhguesit afatgjate të serbska lista.

**Yll Buleshkaj**: Iniciativa qytetare për Obiliqin një subjekt tjetër i certifikuar, ka aplikuar për akreditimin e 7 vëzhguesve afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 9 vota për, akreditohen 7 vëzhguesit afatgjatë të iniciativës qytetare për Obiliqin.

**Yll Buleshkaj**: OJQ-ja Nga Gracanica ka aplikuar për akreditimin e 3 vëzhguesve të cilët ju paraqesim para juve për tu aprovuar.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 11 vota për, akreditohen 3 vëzhguesit afatgjate të OJQ-së vendore...

**Yll Buleshkaj**: Partia politikë e certifikuar “Nova Demokratska Stranka” ka aplikuar më akreditimin e 10 vëzhguesve afatgjate të cilët kane plotësuar të gjitha konditat për tu akredituar dhe rekomandojmë para jush për akreditim.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 10 vëzhguesit afatgjatë të të këtij subjekti...

**Yll buleshkaj**: Subjekti tjetër politike i akredituar “Jedisntvena Gorsnanska Partija” ka aplikuar për akreditimin e 4 vëzhguesve afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 4 vëzhguesit afatgjatë të këtij subjekti...

**Yll Buleshkaj**: Subjekti politik “Iniciativa qytetare për Fushe Kosovë egjiptian hashkalie”, ka aplikuar për akreditimin e 28 vëzhguesve të tyre afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 28 vëzhguesit afatgjatë të këtij subjekti.

**Yll Buleshkaj**: Iniciativa qytetare “Demokratët për Drenasin”, një subjekt tjetër politike i certifikuar ka aplikuar për akreditimin e 8 vëzhguesve.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 8 vëzhguesit afatgjatë të iniciativës qytetare “Demokratet për Drenasin.”

**Yll Buleshkaj**: Subjekti politik i certifikuar “Partia e Drejtësisë” ka aplikuar për akreditimin e 9 vëzhguesve afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 9 vëzhguesit afatgjatë të kësaj partie politike.

**Yll Buleshkaj**: Subjekti tjetër politik iniciativa qytetare “Lista e pavarur Bekim Jashari”, ka aplikuar për akreditimin e 35 vëzhguesve afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Atëherë, akreditohen 35 vëzhguesit e kësaj initiative.

**Yll Buleshkaj**: Media vendore Radio KM, ka aplikuar për akreditimin e 6 vëzhguesve.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 6 vëzhguesit afatgjatë të medias vendore Radio KM.

**Yll Buleshkaj**: Subjekti politike i certifikuar: kandidati i pavarur “Hajrush Stublla” ka sjell edhe një kandidat tjetër për tu akredituar si vëzhgues.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohet një vëzhgues afatgjatë.

**Yll Buleshkaj**: Subjekti politik AKR i cila është po ashtu subjekt politik i certifikuar, ka aplikuar për akreditimin e 1023 vëzhguesve afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 1023 vëzhguesit të partisë politikë AKR-ë.

**Yll Buleshkaj**: Media Radio Televizioni i Kosovës 2, ka aplikuar për akreditimin e 21 vëzhguesve afatgjatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohen 21 vëzhgues të medias vendore Radio Televizioni i Kosovës 2.

**Yll Buleshkaj:** Misioni vëzhgues i unionit evropian, na ka sjell edhe një liste të re për akreditim të vëzhguesve: janë 22 vëzhgues shtesë.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Me 10 vota për, akreditohe 22 vëzhgues afatgjatë të OJQ-së ndërkombëtare “EU-EUM”.

### **3.Raport i Këshillave të KOZ-së**

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

#### **1.Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për zgjedhjet për Kryetar Komune dhe Kuvendin Komunal:**

**Arianit Elshani:** Faleminderit. KOZ-i e ka shqyrtuar propozimin e sekretariatit për procedurat e QNR-së për zgjedhjet për kryetare komune dhe kuvend komunal të zgjedhjeve të 17 tetorit kjo proceduralit ka qene e miratuar në KQZ-ë në të kaluarën. Mirëpo, ka pësuar ndryshime për shkak të vendimeve që kemi marr këtu bashkërisht , e para një nga rekomandimet që ka ardhur nga KOZ-ë që është lidhur më votuesit të cilët votojnë më kushte mirëpo që nuk janë pjese e listës votuese, pra në të kaluarën duke përfshire edhe zgjedhjet e 14 shkurtit ata votues që janë pra rreth 1000 votat e tyre nuk janë normuar fare dhe janë refuzuar pra si kërkesë duke e respektuar edhe ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe ligjin për zgjedhjet lokale kemi kërkuar nga sekretariati që këta persona të cilët nuk figurojnë fare në listën votuese të listohen të gjitha të krijohen një data baze e tyre dhe pastaj të rekomandohet në KQZ-ë; Të bisedojmë, të komunikojnë më agjencinë e regjistrimit civil, përkatësisht me ministrinë e punëve të brendshme që të konfirmojnë në qofte se ata persona, pra ka mundur te ndodhe ndonjë ndryshim nga ARC-ja dhe që, ka mundur pastaj mos me u përfshi në listën votuese që e kemi marr nga ta si ekstrakt. Pra, kjo është një nga rekomandimet dhe procedurat që është vendos brenda kësaj procedure dhe tjetër është në raport me flikat që kemi marr si vendim duke marr parasysh pa rregullsitë lëshimet që kanë mundur të ndodhin, qoftë ato gabime qoftë ato tendencioze.

Nga këshillat e vendvotimeve, këtë rast nga komisionarët e subjekteve politike brenda vendvotimeve ku kemi marr vendim që nga një flike nga ato vendvotime të jete jashtë kutisë se votimit dhe ti dorëzohet KQZ-së dhe pastaj QNR-së një propozim i cili, nuk është diskutuar realisht në këshillin për operacione zgjedhore. Mirëpo, që na ka ardhur një email nga sekretariati është 10% e këtyre flikave, pra 10% e komunave të auditohen nga QNR-ja në mënyre që të verifikojmë saktësinë e atyre flikave me formularë të rezultateve. Kjo është një nga

rekomandimet jashtë KOZ-ë që do ta votojmë veçmas dhe pastaj, çka janë të përfshira tjerat janë dhe ne e dimë se në zgjedhjet e fundit kemi pasur një rast të evidentuar; Për këtë rast, ne kemi marr bashkërisht vendim që t'i huazojmë 50 kamera nga Shqipëria të cilat, do të jenë afër çdo vendnumërimi brenda QNR-së dhe, do të jenë brenda gjithë atyre hapësirave për të vëzhguar nga afër secilin veprim të punonjësve brenda QNR-së, dhe për ta ruajtur vullnetin e qytetareve dhe për mos të lënë askënd që të e manipuloj apo të prek votën e qytetareve...

Kemi kërkuar si këshill për operacione zgjedhore që të caktohet saktë numri i vendnumërimeve dhe koha që merr ky proces i numërimit, pra ne të kemi një hartë dhe këtë procedure po e vendosi edhe për shkak të kërkesës për të qene sa më i shkurt në këtë prezantim, e kemi vendosur që këtë procedurë, dhe e rekomandojmë që të gjitha ato vendime që kemi marr të jenë të përfshira brenda kësaj duke shtuar këtu propozimin e sekretariatit për auditimin e 10% të komunave përkatëse.

Këtë, mbase po e la veçmas si procedurë, dhe ne parimisht rekomandojmë që të aprovohet dhe pastaj, vendosim edhe shtesën, pra kërkesën e sekretariatit për ta shtuar edhe rekomandimin tjetër që të auditohen 10 % e flikave...t.

**Alim Rama:** Unë, vetëm pas rekomandimit, diskutimit të komisionit zgjedhore kemi kërkuar që të rregullohet pika 41, faqe 39: mënyra se si është reformuar paragrafi i parë që i përjashton të gjitha të tjerat ose fjalia e parë kështu që, fjala nuk është “refuzohet” mirëpo, “mundet” me u pezullua deri në verifikime ose diçka ngjashëm, por kështu nëse bëhet, do të thotë “refuzohet” atëherë, s’ke nevojë me bë hetime për në lidhje me vota. Kërkesa ka qene njëherë ato të pezullohen dhe pastaj të behet verifikimi dhe tani të vendoset në baze të të gjeturave. A pranohen ato fletëvotime? Ose, ata personat shkojnë në prokurori se, në fund fundit, në qoftë se dikush ka një letërnjoftim e nuk ndodhet as një listë, atëherë dikush ka bërë shkelje...

Pra, duhet të behet hetimi i prokurisë lidhur më ato dokumente...

Sa i përket këtij “10%”-it, unë vetëm e kam frike sa e zgjatë ajo procesin se, ajo del që diku 240/250 përafërsisht vendvotime, kanë me u auditue. Unë, kisha propozuar që të shkon në mënyre progresive, të hetohen 5% nëse qofte se nuk ka probleme atëherë, nuk preket ajo komunë, në qofte se ka nevojë të preket, atëherë shkon 50% ose në fund të fundit e gjithë komuna...

**Sami Kurteshi:** Faleminderit, unë kam bërë përpjeke me e pa këtë tekst krejt, në fund të raportit thotë “të gjitha të gjeturat e të gjitha hetimeve raportohen në KQZ-ë e cila merr të gjitha



vendimet përfundimtare”! Kjo, është fjalia kryesore në krejt tekstin dhe mandej, janë disa hapa të hetimeve edhe në fund të këtyre hapave të hetimeve, thotë “nëse hetimi zgjidhet” edhe nëse nuk zgjidhet dhe aty kemi dallime që ndoshta është mirë me i pa dikush më shumë kujdes...

Unë kam bërë përpjekje me e lexuar se çka do të thotë hetim ! Për mua, disa procedura janë mbi 60 faqe, përfundimisht çdo vendvotim që del me mangësi të tilla që dërgon në rinumërim jo për shkak të kësaj rastësisë që zgjidhen ato komuna po, çdo vendvotim që shkon në rinumërim për shkak të lëshimeve që janë bere të çfarëdo natyre, duhet me shkuar në hetim jo për shkak gabimeve njerëzore apo diçka po, ku vërehen lëshime që nuk përkasin me të gjitha trajnimet më të gjitha rekomandimet, me të gjitha udhëzimet që i ka bërë KKZ-ja...

**Burim Ahmetaj:** Më lejoni të përgjigjem në disa pyetje që u ngritën do të bëjmë ndryshimin krahas kërkesës së KQZ-së në faqen 39-ë ndryshimin do të bëjmë prej vendimit të KQZ-së. Ndërsa sa i përket hetimeve, janë çështje procedurale të brendshme mirëpo, të gjitha rastet ekipi i hetimit - i rekomandon udhëheqësit të QNR-së, e pastaj udhëheqësi i QNR-së i rekomandon KQZ-së, d.m.th., të gjitha rastet që zgjidhen, patjetër që duhet vendimmarrje e KQZ-vë sepse QNR-ja nuk ka në kompetence asnjë kuti me e hap dhe me e rinumëruar pa vendimin e KQZ-së. Ndërsa, sa i përket mostrës “10%” ne konsiderojmë që është e mjaftueshme; Nuk na merr shumë kohë më i hetuar te gjitha këto vendvotime edhe pse e kemi një listë paraprake pa e ditë se cilat vendvotime mund të kenë probleme ose jo!

**Kreshnik Radoniqi:** E hedh në votim ? Kush është për miratimin e procedurave të QNR-së?

Me vota unanime, miratohen procedura e QNR-së për zgjedhjet për kryetare komune dhe kuvendet komunale.

## **2.Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të VPNRV:**

**Arianit Elshani:** KOZ-i, ka shqyrtuar procedurën e votimit të personave më nevoja dhe rrethana të veçanta janë ndryshime pra të vogla të cilat reflektojnë vendimet e marruara në KQZ-ë për dokumentet e pranishme të identifikimit pastaj edhe për shtojcën e kodit penal këto janë si plotësim i kësaj procedure. I keni pasur edhe para vetes edhe në mbledhjen e kaluar dhe rekomandojmë që të votohet. Në parim, kjo është për stafin i cili do të jetë i angazhuar për t'i mundësuar votimin secilit person me nevoja dhe rrethana të veçanta të cilët, janë të institucione të ndryshme apo të ngjuar në shtëpi, faleminderit.

**Kreshnik Radoniqi:** A ka dikush diçka lidhur më këtë pikë? Nëse jo, kush është për ?

Me vota unanime, votohet procedura për votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta.

### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të pranim dorëzimit të materialet zgjedhore nga KVV-KKZ:**

**Arianit Elshani:** Ne, po ashtu, kemi shqyrtuar edhe procedurën e pranim dorëzimit të materialeve zgjedhore në ditën e zgjedhjeve nga këshillat e vend votimeve në depot e komisioneve komunale të zgjedhjeve. Edhe këtu, reflektojnë të gjitha ato vendime të marruara në KQZ- lidhur me procedurën e pranim - dorëzimit të flikave. Pra, si shtojcë e veçantë brenda këtij dokumenti, pastaj edhe lidhur me materialin sensitiv dhe atë jo sensitiv, pra duhet të dorëzohen të gjitha këto në depot e KKZ-së në mënyrë pra që të kursejmë parandë publike ashtu siç janë marr edhe vendimet e KQZ-së...

**Sami Kurteshi:** Unë, e kam lexuar me shumë kujdes, dhe mendoj që në rregull është, po unë vetëm një çështje po e ngris: çështja kryesore po mendoj e krejt hallkave, e krejt zingjirit që kemi ne kur vjen puna te rinumërimi, vërtetë nëse kjo hallkë rregullohet si duhet dhe KKZ-të kanë kujdes të shtuar gjatë pranimit të materialeve nga këshillat e vendvotimit...?

Në këtë pyetje u përgjigj z. Elshani i cili, shpjegoi se the se kjo është një çështje shumë e rëndësishme për shkak se vërtetë deri më tani ndoshta nuk kemi pasur procesverbale apo dokumente të cilat, kanë verifikuar saktë se ku është një dokument, një kuti apo se çfarë ka brenda saj; A janë të gjithë ato materiale që do të duhej të ishin ? Pra, ne e kemi kuptuar në QNR-ë se çfarë ka dhe çfarë s'ka brenda saj...! Mirëpo, kësaj radhe ne edhe kemi kërkuar që edhe në këshillat e vendvotimeve dhe, edhe në KKZ-ë të kemi një “çek listë” të materialeve pra, të dimë se çfarë ka pranuar KKZ-ja, të dimë së çfarë ka pranuar QNR-ja, dhe si KOZ kemi insistuar që të vendosim edhe “bar code”, pra të mund të skanohen edhe kutitë e votimit dhe të gjitha këto, në mënyrë të sakte të evidentojmë se ku ka mbetur një material...

**Rifat Krasniqi:** Unë, kam një pyetje për krye shefin: A janë ata komisionarë që janë aty dhe, për arsyet e tyre ata s'duan me e nënshkrua kur bohet pranimi i materialit ? A kemi diçka çfarë mundemi ne me ba me ata komisionarë ? Sepse, për shkaqe politike ose pse i ka humbur partia ka ikur dhe, nuk kanë dashur me nënshkruar, as me e paketuar materialin, as me e pranuar materialin...

**Burim Ahmetaj:** Të gjithë komisionarët të cilët angazhohen për të punuar në vendvotim, marrin përgjegjësi për mbarëvajtjen e procesit zgjedhore në ditën e zgjedhjeve dhe në fund fare, obligohen që të nënshkruajnë, të përgatitin rezultatet në baze të rezultatit që dalin nga kutit e votimit dhe ata formularë të rezultateve duhet patjetër të nënshkruhet, pavarësisht prej rezultatit se çfarë del prej kutive të votimit...

Në këtë pikë, diskutuan edhe Alim Rama dhe Sami Kurteshi.

**Kreshnik Radoniqi:** A e hedhim në votim këtë pikë? Kush është për këtë rekomandim ? Me vota unanime, miratohet procedura e pranimit dhe dorëzimit të materialeve zgjedhore nga KKZ në KKZ-ë.

#### **4.Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes se kryesuesve në vendvotim për zgjedhjet lokale 2021:**

**Arianit Elshani:** E kemi shqyrtuar një kërkesë nga sekretariati lidhur me miratimin e përbërjes se kryesuesve se zgjedhjeve lokale 2021. Për shkak të hamendsimeve që kishin komisionet komunale të zgjedhjeve dhe interpretimit të anshëm që kishin në raport më ligjin që e rregullon përbërjen e kryesueseve për këshilla të vendvotimeve, kemi vendosur që të kemi një rekomandim të qartë, një udhëzues në raport më të gjitha KKZ-të për përbërjen e kryesuesve të këshillave vendvotimit sepse, ligji vërtet specifikon qarte subjektet politike të cilat kanë të drejtën e kryesuesve në vendvotime edhe për shkak të transparencës se opinionit publik, mirëpo edhe për shkak të nevojës së KKZ-të të kemi një qartësim; Është rekomandimi ku specifikohet qartë se LVV, PDK, LDK, AAK dhe LS kanë të drejtën e tyre për të pasur kryesues, ju takon këtyre subjekteve për të pasur kryesues të këtyre vendvotimeve ndërsa në komunat specifike, do të përdoret formula tjetër proporcionale për subjektet politike të certifikuar në atë komunë; Pra ky është rekomandimi...

**Rifat Krasniqi:** Unë kërkoj nga krye shefi dhe drejtori i KKZ-së që me e zbatuar këtë vendim të KQZ-së në krejt komunat...

**Kreshnik Radoniqi:** E hedh në votim. Kush është për ? Me vota unanime, votohet përbërja e kryesuesve në vendvotim për zgjedhjet lokale 2021.

## **5.Shqyrtimi dhe plotësim-ndryshimi i përbërjes së KVV-ve sipas komunave përkatëse:**

**Arianit Elshani:** KOZ-i, e ka shqyrtuar edhe kërkesën që ka ardhur si rezultat pas vendimit të marr në KQZ-ë për përbërjen e komisioneve pra, të këshillave të vendvotimit dhe, meqë në disa komuna kemi mundur të bëjmë lëshime për shkak të kohës së shkurt për tu trajtuar këto nga KOZ-ë në KQZ-ë, pra subjektet politike kanë dërguar ankesat e tyre lidhur me përbërjen e këshillave të vendvotimit. Ne, i kemi shqyrtuar këto ankesa në disa komuna: bëhet fjalë për komunën e Dragashit, Istogut, Kamenicës, Novobërdës, Skenderajt, Shtërpcës, Zveçanti dhe Mitrovicës së Veriut. Këto janë komunat ku ka ndryshuar përbërja e këshillave të vendvotimit...

**Kreshnik Radoniqi:** A ka dikush diçka lidhur më këtë plotësim dhe ndryshim ? Nëse jo, atëherë kush është për? Me vota unanime votohet plotësim ndryshimi i përbërjes së KKV sipas komunave përkatëse.

## **6.Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës:**

**Arianit Elshani:** Parimisht, të gjitha këto rekomandime për kandidatet e radhës duhet të trajtohen në këshillin për çështje ligjore por, ndoshta edhe e tejkalojmë këtë rast edhe për shkak të kohës dhe rrethanave, mirëpo parimisht këto të gjitha duhet të shkojnë në këshill për çështje ligjore pastaj, të rekomandohet KQZ-së. Sidoqoftë, jam që të trajtohet tani si kërkesë...

**Florian Dushi:** Ka të drejt kolegu! Sipas rregullave tona, ne i shqyrtojmë por vendimi final megjithatë, është i KQZ-së. Prandaj, nëse sekretariati na konfirmon që gjithçka është zhvilluar sipas procedurave në pjesën e përgjegjësive të tyre që është, ne mund të vendosim si KQZ duke e tejkaluar një hallke që, zakonisht e kryen këtë punë, por po them se vendimi përfundimtar është i KQZ-së.

**Burim Ahmetaj:** Konfirmojmë prej Sekretariatit se, janë kryer të gjitha verifikimet dhe kandidati i radhës i plotëson kushtet për tu emëruar deputet i republikës së Kosovës.

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë, e hedhim në votim. Kush është për rekomandimin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Hysen Berisha ? Me vota unanime, kandidat i radhës z. Hysen Berisha, e zëvendëson deputetin e deritanishëm, z. Uran Ismaili.

## **5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik**

**Fazli Stollaj**: Faleminderit kryesues. Këshilli për Mbikëqyrje të Informimit Publik, me datën 15 shtator ka shqyrtuar dhe miratuar videon dhe audio incizimi për mënyrën se si te votohet për kryetare komune dhe për kuvende komunale. Në të njëjtën mbledhje, janë shqyrtuar dhe miratuar edhe dizajnët që kane të bëjnë për informimin për këtë çështje edhe për rrjete sociale, si dhe postieri po për të njëjtën çështje d.m.th, se si të votohet në ditën e zgjedhjeve për kryetar komune dhe kuvend komunal. Është miratuar edhe për media për sponsorizime që përfshinë detaje që kërkohen dhe, datat kur do të sponsorizohen këto produkte. Si dhe postieri i cili, përmban përpos asaj që tregon se si të votohet, edhe se cilat dokumente mundet të përdoren në ditën e votimit për të votuar. Këto posterë, do të vendosen të gjitha vendvotimet. Kjo, ishte

## **6. Shqyrtimi dhe miratimi i vlerësimit vjetor të punës së Krye shefit Ekzekutiv në SKOZ-së.**

## **7.Të ndryshme!**